

**VENDIM**

**Nr. 180, datë 13.2.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MAKINERIVE E TË PAJISJEVE QË JANË  
DREJTPËRDREJT TË LIDHURA ME INVESTIMIN DHE TË PROCEDURAVE TË  
PËRJASHTIMEVE E TË KRITEREVE PËRKATËSE  
“I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “g”, “gj” e “i” të nenit 261/1 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në zbatim të shkronjave “g”, “gj” e “i” të nenit 26.1 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, të ndryshuar, subjekt i këtij vendimi janë:

- a) tatimpaguesit që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë në ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;
- b) tatimpaguesit që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv, pavarësisht nga vlera e investimit;
- c) tatimpaguesit (përfshirë fermerin) që importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;
- ç) tatimpaguesit, subjekt i taksës së biznesit të vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre.

2. Importimi i makinerive dhe pajisjeve të kryera nga tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importimi kryhet nga vetë tatimpaguesit, pa nënkontraktim. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin është e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të cilët importojnë makineri dhe pajisje për të përfituar përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar, duhet të pajisen me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD). Për marrjen e këtij autorizimi, subjektet duhet të paraqesin në DPD dokumentet, si më poshtë vijon:

3.1 Tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- b) kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit në ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);
- c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është në ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;
- ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe periudhën e instalimit;
- dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

3.2 Tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- b) kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e përpunimit aktiv. Verifikimi nëse ka ose jo autorizimin e lëshuar nga autoriteti doganor si tatimpagues në regjimin e përpunimit aktiv kryhet brenda strukturave doganore;
- c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për të gjithë kohëzgjatjen e investimit;
- ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;
- dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

3.3 Tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- b) kopje të ekstraktit të QKR-së, ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e agrobiznesit;
- c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin dhe kohëzgjatjen e investimit;
- ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;
- dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

3.3.1 Në rastin e importit nga fermeri, tatimpaguesit paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Një kërkesë me shkrim, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore.
- b) Vërtetim nga drejtoria rajonale e bujqësisë se është fermë.
- c) Kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të tokës.
- ç) Të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e importimit.

3.4 Tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “9” të pikës 1 të këtij vendimi, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- b) vërtetim nga bashkia ose komuna se është subjekt i taksës së biznesit të vogël dhe ushtron aktivitet prodhues;
- c) vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore se është subjekt i taksës së biznesit të vogël;
- ç) kopje të ekstraktit të QKR-së;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese që do të importohen dhe për periudhën e instalimit.

3.5 Importimet e makinerive e të pajisjeve të kryera në përputhje me shkronjat “g”, “gj” e “i” të nenit 26.1 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, të ndryshuar, subjekt i këtij vendimi, të bëra me ndërmjetësimin e kompanive *leasing* janë subjekt i përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Subjektet përfituese duhet të paraqesin në doganë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Respektivisht sipas kategorisë së tatimpaguesit, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në pikat 3.1; 3.2; 3.3 dhe 3.4 të këtij vendimi.
- b) Kopje të kontratës me kompaninë *leasing*.

4. Me plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, DPD-ja e pajis tatimpaguesin me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, në të cilin përcaktohet edhe dega doganore mbikëqyrëse. Nëse administrata doganore nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, autorizimi konsiderohet i dhënë. Një kopje e autorizimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPD-ja hap një regjistër të veçantë për importet që kryhen nga tatimpaguesit importues. Për çdo import të makinerive e të pajisjeve, personat e tatueshëm duhet të paraqesin kërkesat e parashtruara në këtë vendim për t'u pajisur me autorizim përjashtimi. Personat e tatueshëm, që importojnë makineri dhe pajisje për shitje, nuk janë subjekte përfituese.

5. Për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, të cilët kanë importuar makineri dhe pajisje nën skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së dhe afati i dhënies së autorizimeve nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave nuk ka mbaruar deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 125/2012, datë 20.12.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, dega doganore mbyll situatën e tatimpaguesit përmes ndryshimit të deklaratës doganore, për përjashtimin nga TVSH-ja, dhe, njëkohësisht, deklarata e ndryshuar dhe e miratuar nga organi doganor shërben për kontabilitetin e shoqërisë për tatimpaguesin. Mbyllja e situatës bëhet vetëm për mallrat e listuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Dega doganore njofton drejtorinë rajonale tatimore për mbylljen e procedurës së përjashtimit për të tilla subjekte. Këta tatimpagues duhet të paraqesin pranë degës doganore, ku kanë bërë procedurat e importimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për shuarje të borxhit doganor;
- b) Kopje të autorizimit të shtyrjes së pagesës së TVSH-së nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave;
- c) Listën e makinerive e të pajisjeve të importuara nën skemën e shtyrjes së TVSH-së, si dhe të dhënat për deklaratat doganore me të cilat këto makineri dhe pajisje janë importuar.
- ç) Kopje të autorizimit për regjimin e përpunimit aktiv për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi;
- d) Respektivisht sipas kategorisë së tatimpaguesit, të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikat 3.1, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e”; 3.2, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e”; dhe 3.3, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e” të këtij vendimi.

6. Për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, të cilët kanë bërë importim të makinerive e të pajisjeve nën skemën e shtyrjes së TVSH-së, por që iu ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 125/2012, datë 20.12.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, dhe nuk kanë TVSH për rimbursim tek administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor. Këta tatimpagues duhet të paraqesin pranë degës doganore, ku kanë bërë procedurat e importimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për shuarje të borxhit doganor.
- b) Njoftimin e vendimit së bashku me vendimin nga dega doganore ku përcaktohet se janë shpallur debitor.
- c) Kopje të autorizimit të shtyrjes së pagesës së TVSH-së nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave.
- ç) Listën e makinerive e të pajisjeve të importuara nën skemën e shtyrjes së TVSH-së si dhe të dhënat për deklaratat doganore me të cilat këto makineri dhe pajisje janë importuar.

d) Kopje të autorizimit për regjimin e përpunimit aktiv për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi.

dh) Kopje të planit të investimit për vitin kur kanë kryer importet. e) Vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore, ku janë regjistruar, se nuk kanë tepricë kreditorë për rimbursim;

ë) Respektivisht sipas kategorisë së tatimpaguesit, të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikat 3.1, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e”, 3.2, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e”, dhe 3.3, shkronjat “b”, “c”, “dh” e “e” të këtij vendimi. Nëse plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e protokollimit të kërkesës së tatimpaguesit, dega doganore mbyll situatën debitore të tatimpaguesit përmes ndryshimit të deklaratës doganore dhe, njëkohësisht, deklarata e ndryshuar dhe e miratuar nga organi doganor shërben për kontabilitetin e shoqërisë për tatimpaguesin. Mbyllja e situatës bëhet vetëm për makineritë e pajisjet e listuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Dega doganore njofton drejtorinë rajonale tatimore për mbylljen e procedurës së shuarjes së borxhit dhe tatimpaguesin.

7. Për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, të cilët kanë bërë importim të makinerive e të pajisjeve nën skemën e shtyrjes së TVSH-së, por që iu ka mbaruar afati i shtyrjes së autorizimit nga administrata doganore apo Ministri i Financave në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 125/2012, datë 20.12.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe kanë TVSH për t’u rimbursuar nga administrata tatimore, u shuhet borxhi doganor për TVSH-në e shtyrë, me kusht që të mos pretendojnë shumën e TVSH-së për rimbursim tek administrata tatimore, deri në shumën e TVSH-së së borxhit që shuhet në doganë.

7.1. Këta tatimpagues duhet të paraqesin pranë degës doganore ku kanë bërë procedurat e importimit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë për shuarje të borxhit doganor.

b) Kopje të autorizimit të shtyrjes së pagesës së TVSH-së nga administrata doganore ose nga Ministri i Financave.

c) Listën e makinerive e të pajisjeve të importuara nën skemën e shtyrjes së TVSH-së, si dhe të dhënat për deklaratat doganore me të cilat këto makineri e pajisje janë importuar.

ç) Kopje të autorizimit për regjimin e përpunimit aktiv për tatimpaguesit e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi.

d) Një vërtetim të lëshuar nga drejtoria rajonale tatimore, ku është i regjistruar, për situatën e TVSH-së që provon ekzistencën e tepricës kreditorë të TVSH-së, si dhe shënohet se ky vërtetim është lëshuar me kërkesë të tatimpaguesit për heqje dorë nga pretendimi për rimbursim të kësaj shume nga organi tatimor deri në shumën e borxhit doganor për TVSH të shtyrë në import për makineri dhe pajisje. Në rast se shuma e TVSH-së kreditorë tek administrata tatimore është më e lartë se shuma e TVSH-së së shtyrë në doganë, subjekti heq dorë nga TVSH-ja kreditorë deri në shumën e TVSH-së së shtyrë në doganë për makineri dhe pajisje. Për diferencën, subjekti rimbursohet nga administrata tatimore sipas legjislacionit në fuqi për këtë fushë.

dh) Respektivisht sipas kategorisë së tatimpaguesit, të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikat 3.1, shkronjat “b” dhe “c”; 3.2, shkronjat “c” dhe “ç”; dhe 3.3, shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të këtij vendimi.

7.2. Nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë vendim, dega doganore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e protokollimit të kërkesës së tatimpaguesit, kryen procedurat e mëtejshme për sistemimin dhe kontabilizimin e pozicioneve debitore të TVSH-së. Dega doganore mbyll situatën debitore të tatimpaguesit përmes ndryshimit të deklaratës doganore dhe, njëkohësisht, deklarata e ndryshuar dhe e miratuar nga organi doganor shërben për

kontabilitetin e shoqërisë për tatimpaguesin. Mbyllja e situatës bëhet vetëm për makineritë dhe pajisjet e listuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Dega doganore njofton subjektin që ka bërë kërkesën dhe drejtorinë rajonale tatimore për mbylljen e procedurës së shuarjes së borxhit doganor për të vijuar me procedurat për heqjen e TVSH-së së zbritshme.

7.3 Pas miratimit nga dega doganore, drejtoria rajonale tatimore vlerëson situatën kreditore të tatimpaguesit duke e reduktuar për TVSH-në përkatëse të rimbursueshme deri në shumën e shuar të borxhit të TVSH-së së shtyrë në doganë për makineri dhe pajisje, si dhe njofton me shkrim tatimpaguesin për situatën e tij pas sistemimit në administratën tatimore.

8. Tatimpaguesit, të cilët kanë importuar makineri dhe pajisje nën skemën e regjimit të lejimit të përkohshëm të tyre, që nuk u ka mbaruar afati i regjimit dhe në rast se janë të interesuara të kalojnë nga regjimi i lejimit të përkohshëm në regjim importi, përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së në import të makinerive dhe pajisjeve në rast se janë persona të tatueshëm sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe plotësojnë dhe paraqesin pranë autoriteteve doganore dokumentacionin e përcaktuar, respektivisht, në këtë vendim.

9. Në përfundim të procedurës së shuarjes së borxhit doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njoftojnë Ministrinë e Financave për gjithë listën e tatimpaguesve dhe shumat përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**

**MINISTRI I FINANCAVE**

**RIDVAN BODE**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 44, datë 2 prill 2013.

Ndryshuar me Vendimin Nr. 671, datë 7.8.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 137, date 7.8.2013.

Vendimi Nr. 671, datë 7.8.2013 shfuqizohet me Vendimin Nr. 866, datë 30.9.2013, Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 165, datë 17 tetor 2013.

Ndryshuar me VKM, Nr. 348, datë 04 06 2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 85, datë 11 qershor 2014.



|          |  |
|----------|--|
| 84136070 | Popmat vide  |
| 84136080 | Te tjera   |
| 84137021 | Me një fazë  |
| 84137029 | Shumëfazësh  |
| 84137030 | Pompat forcuese glandless për sistemet ngrohëse dhe pajisjet me ujë të ngrohtë           |
| 84137035 | Deri 15mm  |
| 84137045 | Pompat forcuese me kanal dhe pompat me kanal anesor                                      |
| 84137051 | Njebloksh  |
| 84137059 | Te tjera   |
| 84137065 | Me me shume se nje hyrje force   |
| 84137075 | Shume-stadesh  |
| 84137081 | Nje-stadesh  |
| 84137089 | Shume-stadesh  |
| 84138100 | Pompat   |
| 84138200 | Elevatorët e lëngut  |
| 84139100 | E pompave  |
| 84139200 | Elevatorët e lëngut  |
| 84141020 | Pompat me piston rrotullues, pompat rrotulluese me vane rrëshqitëse,                     |
| 84141025 | Pompat me piston rrotullues, pompat rrotulluese me vane rrëshqitëse, pompat me zvarritje |
| 84141081 | Pompat e difuzionit, kriopompat dhe pompat e adsorbimit                                  |
| 84141089 | Te tjera   |
| 84142020 | Pompa dore per mjete te llojit biçikleta, motorçikleta, triçikla                         |
| 84142080 | Te tjera   |
| 84143020 | Te nje fuqie jo me teper se 0,4 kW   |
| 84143081 | Hermetike ose gjysem-hermetike   |
| 84143089 | Te tjera   |
| 84148075 | Kompresore vide  |
| 84148078 | Te tjera   |
| 84148080 | Te tjera   |
| 84149000 | Pjeset   |
| 84161010 | Të trupëzuar me një mjet automatik të kontrollit   |
| 84161090 | Të tjera   |
| 84162010 | Vetëm për gaz, monoblok, të trupëzuar me një ventilator dhe një mjet kontrolli           |
| 84162020 | Furra te kombinuara  |
| 84162080 | --- Te tjera   |
| 84163000 | Pajisje të ngjashme  |
| 84169000 | Furnaltat dhe vatrat e zjarrit për pjekje, shkrirje apo trajtime të tjera me nxehtësi të |
| 84171000 | metaleve   |
| 84172010 | Furrat tunel   |
| 84172090 | Të tjera   |
| 84178030 | Furrat dhe furnaltat per djegjen e produkteve qeramike                                   |
| 84178050 | -- Furrat dhe furnaltat per djegjen e produkteve te çimentos, xhamit ose kimike          |
| 84178070 | Te tjera   |
| 84179000 | Pjesët   |

|          |   |
|----------|---|
| 84191100 | -- Nxehesat e menjehershëm te ujit me gaz   |
| 84191900 | Të tjera  |
| 84192000 | -- Sterilizuesit mjeksore, kirurgjikale apo laboratorike                                    |
| 84193100 | Për produktet bujqësore   |
| 84193200 | Për drurin, brumin e letrës, letrën apo kartonin  |
| 84193900 | Te tjera  |
| 84194000 | Impjantet distiluese apo pastruese  |
| 84195000 | Njesite e shkembimit te nxehtesise  |
| 84196000 | Makineri për lëngëzimin e ajrit apo të gazeve të tjera                                      |
| 84198120 | Perkoloret dhe pajisje te tjera per berjen e kafese dhe te pijeve te tjera te nxehta        |
| 84198180 | Te tjera  |
| 84198910 | Kullat ftohëse dhe pajisje të ngjashme për ftohje direkt (pa një mur ndarës) nëpërmjet ujit |
| 84198930 | Pajisjet vakum të avujve për depozitimin e metaleve   |
| 84198998 | Të tjera  |
| 84199085 | Te tjera  |
| 84201010 | Të një lloji të përdorur në industrinë tekstile   |
| 84201030 | Të një lloji të përdorur në industrinë e letrës   |
| 84201080 | Te tjera  |
| 84209110 | Prej gize të derdhur  |
| 84209180 | Të tjera  |
| 84209900 | Të tjera  |
| 84211100 | Ndarësit e kremit   |
| 84211920 | Centrifugat e nje lloji te perdorur ne laboratore   |
| 84211970 | Te tjera  |
| 84212100 | Per filtrimin ose pastrimin e ujit  |
| 84212200 | Për filtrimin ose pastrimin e pijeve të ndryshme nga uji                                    |
| 84212300 | Filtrat e vajit ose naftes per motoret me djegie te brendshme                               |
| 84212900 | Te tjera  |
| 84213100 | Filtrat e marrjes se ajrit per motoret me djegie te brendshme                               |
| 84213920 | Makineri dhe aparatura per filtrimin apo pastrimin e ajrit                                  |
| 84213960 | Nepërmjet nje procesi katalitik   |
| 84213980 | Te tjera  |
| 84219100 | E centrifugave, perfshire tharesit centrifugale   |
| 84219900 | Të tjera  |
| 84222000 | Makineri për mbushjen, mbylljen, vulosjen apo etiketimin e shisheve, kanaçeve, kutive,      |
| 84223000 | Makineri për gazimin e pijeve   |
| 84224000 | Makineri të tjera paketime apo mbështjellje (përfshirë makineritë e mbështetjes me          |
| 84229090 | Të tjera  |
| 84232000 | Peshoret e peshës konstante dhe peshoret për shkarkimin e një peshe të paracaktuar të       |
| 84233000 | Peshoret e kontrollit dhe makinat automatike të kontrollit që punojnë nëpërmjet një         |
| 84238110 | Të pacaktuara   |
| 84238130 | Makineri për peshim dhe etiketim të mallrave të parapaktuara                                |
| 84238190 | Peshoret e kontrollit dhe makinat automatike të kontrollit që punojnë nëpërmjet një         |
| 84238210 | Të pacaktuar  |



|          |  |
|----------|--|
| 84238290 | Të tjera   |
| 84238900 | Të tjera   |
| 84239000 | Peshat e të gjitha llojeve; pjesët e makinave peshuese                                 |
| 84243001 | Me mjet nxehës   |
| 84243008 | Te tjera   |
| 84243010 | Që punojnë me ajër të kompresuar   |
| 84243090 | Të tjera   |
| 84248110 | Pajisje ujitëse  |
| 84248130 | Pajisje portative  |
| 84248191 | Sprucuesit dhe distributorët që punojnë me fuqi të destinuar për t'u moshtuar mbi apo  |
| 84248199 | Të tjera   |
| 84248900 | Te tjera   |
| 84249000 | Pjeset   |
| 84253100 | Te fuqizuar me motor elektrik  |
| 84253900 | Te tjera   |
| 84261100 | Vinçat e lëvizshëm mbi tokësor mbi një suport të fiksuar.                              |
| 84261200 | Struktura ngritëse të lëvizshme mbi mbajtësa me rrota gome dhe shtylla.                |
| 84261900 | Vinç lëvizës mbitokësor, transportier, vinç-ure, kullë mbështetës, struktur ngritës    |
| 84262000 | Vinça kolone   |
| 84263000 | Vinça me krah portal apo pedestal  |
| 84264100 | Vinça me kamion pune i pajisur me vinç, vetëlëvizëse, mbi rrota gome.                  |
| 84264900 | Vinça të lëvizshëm dhe mjet pune i pajisur me vinç, vetëlëvizëse (jo:rrota gome etj)   |
| 84271010 | Me një lartësi ngritjeje prej 1 m apo më shumë.  |
| 84271090 | Të tjera   |
| 84272011 | Ngritësit-pirun të terrenit të fortë dhe kamiona të tjerë stacking                     |
| 84272019 | Të tjera   |
| 84272090 | Të tjera   |
| 84279000 | Mjete të tjerë   |
| 84282020 | Per materiale me shumice   |
| 84282080 | Te tjera   |
| 84283100 | Elevatore dhe konvenierë për veprim të vazhdueshëm, për përdorim nëntokësorë, jo       |
| 84283200 | Elevatore dhe konvenierë për veprim të vazhdueshëm, për mallra o materiale të tipit me |
| 84283300 | Te tjera, tip me rrip  |
| 84283920 | Konvejeret ne forme roleje   |
| 84283990 | Te tjera   |
| 84284000 | Eskalatorë dhe pjesë lëvizëse të rrugës  |
| 84286000 | Teleferike, ashensore në formë karrige, dragolinja rrëshkitëse, mekanizma tërheqës.    |
| 84289071 | Ngarkuesit të destinuar për t'u bashkangjitur në traktorët bujqësorë.                  |
| 84289079 | Ngarkues për t'u përdorur në bujqësi (jo: për t'iu bashkangjitur traktorëve bujqësor). |
| 84289090 | Te tjera   |
| 84291100 | Buldozier dhe kendozier vetëlëvizës, kamiona shtrues.                                  |
| 84291900 | Buldozier dhe kendozier vetëlëvizës, mbi rrota.  |
| 84292000 | Shtrues dhe nivelues vetëlëvizës, mbi rrota.   |
| 84293000 | Skraperat vetëlëvizës.   |

|          |   |
|----------|---|
| 84294010 | Vibratorë dhe rulet e rrugëve, vetëlëvizëse.  |
| 84294030 | Makina ngjeshëse vetëlëvizëse (ndryshe nga makinat vibratore ngjeshës).                       |
| 84294090 | Makina ngjeshëse vetëlëvizëse (jo: rulat e rrugëve).  |
| 84295110 | Ngarkuesit vetëlëvizës me lopata "front-end" për përdorim nëntokë.                            |
| 84295191 | Ngarkues me lopatë "front-end" mbi makinë skrapër (ndryshe nga për përdorim                   |
| 84295199 | Ngarkues vetëlëvizës me lopatë "front-end" (ndryshe nga nentokësor).                          |
| 84295210 | Gërmues lëvizës mbi makinë skreper me rrotullim të superstrukturës 3600)                      |
| 84295290 | Gërmues me rrotullim të superstrukturës 3600 (ndryshe nga mbi makinë skrapër)                 |
| 84295900 | Lopata mekanike, eskavator e ngarkues me lopata (jo:lopata mekanike me superstructure         |
| 84301000 | Makina e vendosjes dhe të nxjerrjes së kolonave (jo: ato të montuara mbi vagon                |
| 84303100 | Makineri vetëlëvizës prerje qymyri, guri dhe shpim tuneli.                                    |
| 84303900 | Makineri jo vetëlëvizës prerje qymyru, guri dhe shpim tuneli (jo:mjete për operim me          |
| 84304100 | Makineri vetëlëvizëse shpuese, zhytëse për shpim toke, nxjerrje minerali o xeherori.          |
| 84304900 | Makineri jo vetëlëvizëse shpuese, zhytëse për shpim toke ose nxjerrje minerali, xeherori.     |
| 84305000 | Makineri vetëlëvizëse lëvizëse të dheut.  |
| 84306100 | Makineri ngjeshëse apo kompaktuese, jo vetëlëvizëse (jo:mjete të operimit me dorë).           |
| 84306900 | Makineri për lëvizjen e dheut, jo vetëlëvizëse.   |
| 84312000 | Të makinerive të kreut nr.8427  |
| 84321000 | Plugjet   |
| 84322100 | Lesat me disk për përdorim në bujqësi, kopshtari dhe pylltari.                                |
| 84322910 | Kultivatorët  |
| 84322930 | Lesat për përdorim në bujqësi, kopshtari dhe pylltari. (jo:lesat disk)                        |
| 84322950 | Rotovator për përdorim në bujqësi, kopshtari dhe pylltari.                                    |
| 84322990 | Kultivatorë dhe teharës për përdorim në bujqësi, kopshtari dhe pylltari (jo:rotatororët)      |
| 84323011 | Mbjellës me drejtim qendror të hapësirave të caktuara për përdorim në bujqësi, kopshtari.     |
| 84323019 | Mbjellës për përdorim në bujqësi, kopshtari, (jo:drejtim qendror të hapësirës mbjellëse)      |
| 84323090 | Mbjellësat,plantuesit dhe transplantuesit për përdorim në bujqësi, kopshtari e pylltari.      |
| 84324010 | Shpërndarësit e plehut mineral apo kimik, për përdorim në bujqësi, kopshtari e pylltari.      |
| 84324090 | Shpërndarësit e plehut organik/përzjerje të tij, përdorur në bujqësi, kopshtari e pylltari.   |
| 84328000 | Makineri agriculture për përgatitje toke, kultivim; rula lëndine o fushë sporti.              |
| 84329000 | Pjesë për makineri agrikulturë për përgatitje toke, kultivim; rula lëndine o fushë sporti.    |
| 84331110 | Makinë kositëse për lëndinë e tj; elektrike, me pajisje prerëse që rrotullohet plan           |
| 84331159 | Kositëse vetëlëvizës lëndine etj; joelektrike, prerëse e rrotulluese horizontal, me ndenjësë. |
| 84331190 | Kositëse për lëndinë etj; me prerse rrotulluese plan horizontal, jo vetëlëvizëse              |
| 84331951 | Kositëse vetëlëvizëse lëndine etj; joelektrike, prerëse rrotulluese vertikale me ndenjësë.    |
| 84331959 | Kositës lëndine me motor vetëlëvizës, joelektrike, prerëse rrotullues vertical, pa ndenjësë.  |
| 84331970 | Kositës lëndine me motor, jo vetëlëvizëse, joelektrike me prerëse rrotulluese vertikale.      |
| 84331990 | Kositëse elektrike lëndine etj; me prerëse rrotulluese vertikale o me shufra prerëse          |
| 84332010 | Makinë kositëse me motor(jo; për lëndinë, park, fusha sporti).                                |
| 84332050 | Te destinuara për t'u mbajtur apo për t'u terhequr nga nje traktor                            |
| 84332090 | Makina kositëse (jo;për mbartje o tërheqje nga traktor, për lëndinë, park, kositës me         |
| 84333000 | Makineri te tjera perpunimi te barit te thate   |
| 84334000 | Presat për ambalazhimin në dengje të kashtës apo barit të thate, përfshirë presat ngritese    |
| 84335100 | Makinë korrje-shirje e kombinuar.   |



|          |  |
|----------|--|
| 84335200 | Makina shirje jo të kombinuara me ato korrëse.   |
| 84335310 | Nxjerrësit e patateve dhe korrësit e patateve.   |
| 84335330 | Makina e nxjerrjes së panxharit dhe të korrjes së panxharit.                                 |
| 84335390 | Makinë për nxjerrjen e rrënjëve apo zhardhokëve (jo:nxjerrës e korrës patatesh).             |
| 84335911 | Korrëse tagjie, vetëlëvizëse.  |
| 84335919 | Korrëse tagjie, jo-vetëlëvizëse.   |
| 84335985 | Te tjera   |
| 84336000 | Makina për pastrim, zgjedhje o klasifikim të vezëve, frutave/produkteve të tjera             |
| 84339000 | Pjesë për makina korrëse, shirëse, kositëse, pastruese, zgjedhje o klasifikim agrikulturash. |
| 84341000 | Makina mjelëse të qumështit  |
| 84342000 | Makineri mjelëse qumështi e bulmeti (jo:pajisje trajtimi në të ftohtë o të ngrohtë etj.)     |
| 84349000 | Pjesë për makineritë e mjeljes së qumështit o bulmetit.                                      |
| 84351000 | Makineritë   |
| 84359000 | Pjesët   |
| 84361000 | Makineri për përgatitjen e ushqimeve të kafshëve   |
| 84362100 | Inkubatorët e shpendëve dhe ngrohjes së vezëve   |
| 84362900 | Të tjera   |
| 84368010 | Makineri pylltarie   |
| 84368090 | Te tjera   |
| 84369100 | Të makinerive të shpërndarisë apo inkubatorëve të shpendëve dhe të makinave të               |
| 84369900 | Të tjera   |
| 84371000 | Leguminoze   |
| 84378000 | Makineri të tjera  |
| 84381010 | Makineritë e pjekjes   |
| 84381090 | Makineritë për prodhimin e makaronave, psageti apo produkteve të ngjashme.                   |
| 84382000 | Makineri për prodhimin e ëmbëlsirave, kakaos apo çokollatave.                                |
| 84383000 | Makineri për prodhimin e sheqerit  |
| 84384000 | Makineri për destilëritë e birrës  |
